



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.734/22

Gjykata Komeriale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale” me seli në Prishtinë, rr.”....”nr. ...., ndaj debitorit “F...” Sh.p.k.me seli ne fshatin .... p.n Komuna Graçanicë, te cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Besian Sylja, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, te parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega ne Graçanicë, PPPI nr.16/19 të datës 04.10.2019, me datë 10.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit “F...” Sh.p.k.me seli ne fshatin .... p.n Komuna Graçanicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, PPPI nr.16/19 të datës 04.10.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega ne Graçanicë, me aktvendimin e atakuar PPPI nr.16/19 të datës 04.10.2019, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “F...” Sh.p.k.me seli ne fshatin .... p.n Komuna Graçanicë, i ushtruar kundër urdhrorit përmbartimor te përmbartueses private Rezarta Metaj nga Prishtina P.nr.225/18 te datës 25.04.2018,

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar av. Besian Sylja, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje në shkallë të parë.

Përgjigje ndaj ankesës së debitorit ka ushtruar kreditori me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori në ankesën e tij pasi në rastin konkret duhet të merret parasysh neni 361 par.1 te LMD nr.04/L-077ku afati i parashkrimit te gjitha kërkesave është 10 vjeçar e kjo bazuar edhe ne komentuarin e ligjit te LMD neni 449 dhe 450 ku parashihet se neni 361 parashikon te gjitha

kërkesat pa marrë parasysh llojin e tyre që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë nga gjykata ose ndonjë organ tjetër kompetent. Propozon që të refuzohet ankesa e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues-Aktvendimit nr.5029 të datës 20.09.2011 i lëshuar nga Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale, i ekzekutueshëm nga data 08.11.2011 dhe i formës së prerë nga data 24.10.2011.

Përmbartuesja Private Rezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartimin e kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.225/18 të datës 25.04.2018, e ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor.

Ndaj këtij urdhri debitori me datë 06.03.2019, ka parashtuar prapësim, me arsyetimin se kreditori ka parashtuar propozim për përmbartim ndaj debitorit F... me pronar A.D ndërsa i njëjti është vëllai tani i ndjerë i debitorit A.D. Thotë se ka skaduar afati kohor për kërkesën e përmbartimit sepse aktvendimi sipas të cilit kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit është bërë i formës së prerë me datën 24.10.2011 dhe i ekzekutueshëm me datën 08.11.2011 çka do të thotë se ka kaluar afati për përmbushjen e detyrimit, referuar kështu edhe ligjit 02/L-28 PER Procedurën Administrative sipas të cilit afati për ekzekutimin e vendimit është 15 nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit afat ky i paraparë në nenin 121 par.1 të këtij ligji, si dhe bazuar edhe në nenin 157 të LIGJIT NR.05/1-031 PER Procedurën Administrative me të cilin shfuqizohet ligji i mëparshëm e i cili thotë procedurat administrative të përfunduara me datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore që e kanë rregulluar procedurën administrative. Edhe neni 144 par.3 të këtij ligji thotë se akti administrative nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi apo kanë kaluar tre (3) vite nga veprimi i fundit për ekzekutim, Propozon që gjykata ta pranojë këtë prapësim, ta refuzoj urdhrin për përmbartim dhe ta obligoj kreditorin në pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtuar kreditori me datën 18.09.2019, me arsyetimin se prapësimi është i pabazuar sepse nuk përmban kurrfarë arsyetimi të bazuar në fakte dhe prova

konform nenit 71 te LPP. Pretendimi i debitorit se propozimi është bërë në emër të A.D ndërsa pronar duhet te jetë A.D është i pabazë sepse kemi të bëjmë me person juridik (shoqëri me përgjegjësi te kufizuar) kështu që dhe pse drejtori ka ndërruar jetë të drejtat dhe detyrimet kësaj shoqërie i janë bartur A.D, ndërsa në periudhën kur është kryer aktiviteti dhe operimi po ashtu është lëshuar akti administrativ ka qenë pronar A.D e cila gjendje ka qenë dhe në ARBK, dhe edhe pse A.D ka ndërruar jetë shoqëria ekziston dhe është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera me tërë asetet duke përfshirë edhe kapitalin themeltar. Ne këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndërrim të numrit të biznesit por vetëm me të personit fizik i cili ka ndërruar jetë. Shton se debitori 'F...' shpk, është hasur duke ushtruar aktivitetit ilegal minerar për te cilin KPMM ka ndërmarr veprime, po ashtu edhe në bazë të ARBK shihet se data e regjistrimit është 23.07.2007 dhe se në periudhën e inspektimit pronar është A.D. Raporti i inspektimit është bërë me datën 18.11.2010 me numër ....., kreditori i referohet Ligjit nr.04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjykata duhet ta ketë parasysh dispozitën e nenit 361 par.1 te LMD dhe ta zbatoj këtë dispozitë ligjore dhe ta trajtoj këtë ligj në favor të organit administrativ e kjo bazuar edhe në komentarin e LMD neni 449 dhe 450. Vlerëson se afati 10 vjeçar është afat i veçantë i përcaktuar me nenin 144 par.3 te ligjit nr.05/L-031 dhe se ky afat krijon siguri që se paku detyrimet që janë krejtësisht të vërtetat kanë një kohë më të gjatë të përmbushjes nga ana e debitorit. Kjo më së miri është vërtetuar edhe me një vendim të Gjykatës së Apelit Ac.nr.3726/2018 dt.28.01.2019, përveç këtij vendimi kemi pasur edhe raste tjera te gjykuara nga Gjykata e Apelit te cilat e kanë vërtetuar dhe e kanë njohur afatin 10 vjeçar të parashkrimit andaj kreditori argumenton me një prej këtyre vendimeve. Shton se debitori nuk ka ushtruar ankesë në KPMM si organ i shkallës së dytë gjegjësisht në Komisionin e ankesave ashtu që vendimi i KPMM nr.5029 dt.20.09.2011 është bërë i plotfuqishëm, andaj kreditori duke u bazuar ne prova dhe fakte konkrete propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit si te pabazuar dhe ta lë ne fuqi urdhrin përmbarimor.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega ne Graçanicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen ne prapësim te kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin PPPI.nr.16/19 te datës 04.10.2019, me të cilin e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka arsyetuar se debitori ne prapësimin ushtruar nuk ka mbështetur pretendimet e veta me prova me shkrim, me nenin 20 te LPP është përcaktuar se organi përmbarues vepron ne bazë te paraqitjes se provave te dokumentuara e qe ne rastin konkret dokumenti përmbarues aktvendimi i KPMM nr.5029 dt.12.09.2011 është plotëfuqizuar e datën 24.10.2011 dhe bërë i ekzekutueshëm me datën 08.11.2011, ndërsa ligji për Procedurën Administrative 05/L-031 ka hyrë në fuqi me datën 21.06.2017 ndërsa neni 379 par.1 te LMD është paraparë se kërkesat e plotfuqishme te cilat janë sjellë me vendim gjyqësor ose te një organi tjetër kompetent ose me ujdj gjyqësore ose ne ndonjë mënyrë tjetër nga ana e organit kompetent vjetërsohet brenda afatit prej 10 vitesh, edhe atë për te cilin parasheh afate ligjore me te shkurtër për parashkrim. Andaj nga të gjitha këto gjykata refuzon

si të pabazuara pretendimet e debitorit sepse nuk janë plotësuar arsyet ligjore nga neni 69, 71 dhe 73 të LPK ashtu që vendosi si në dispozitiv.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ( KPMM) nr.5029 dt.20.09.2011, i formës së prerë nga data 24.10.2011 dhe i ekzekutueshëm nga data 08.11.2011, është dokument përmbarues, konform nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se *“dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (ujdia”, neni 24 par.3 të LPP i cili thotë se: “vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë” si edhe neni 27 paragrafi 1, i cili thotë se: “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga del se edhe kjo gjykatë pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se aktvendimi i KPMM nr.5029 dt.12.09.2011 përbën titull juridik për përmbarim si dhe konsideron se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Dhoma e Shkallës së dytë vlerëson se pretendimi i debitorit se ka skaduar afati kohor që të kërkohet përmbushja e detyrimit nga ana e kreditorit, nuk qëndron, sepse neni 361 i LMD shumë qartë përcakton se: *“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”* e që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar çështjen bazuar në dispozitë konkrete ligjore e cila trajton edhe afatin e parashkrimit edhe të kërkesave të organeve tjera e që në këtë rast edhe aktvendimit administrativ. Andaj bazuar në aktvendimin e kreditorit si titull përmbarimor nr. .... dt.20.09.2011 dhe paraqitjen e propozimit për përmbarim të datës 25.04.2018, rezulton se detyrimi i debitorit ndaj kreditorit nuk është parashkruar dhe se nuk ka kaluar afati i paraparë prej 10 vitesh me Ligjin Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë,

ndërsa konkludon se debitori nuk ka arrit qe prapësimi t'ia bashkëngjis provat konkrete përkitazi pretendimeve te tij, ashtu siç parashihet me nenin 69.4 te LPP, andaj nuk janë plotësuar arsyet ligjore nga neni 71 par.1 te LPP për te vendosur ndryshe, dhe nuk ka kushte për anulim te urdhrit përmbarimor.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbattoj përmbarimin.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË  
DHOMA E SHKALLES SE DYTË  
K.DH.SH.II nr.734/22, me datë 10.11.2022

Gjyqtarja  
Saranda Bogaj-Sheremeti